



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**  
**SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Për: Operatorin ekonomik “ARB-Trans-2010”shpk** me NIPT L02325001T, me administrator Z. Fatmir Firi, me seli në Adresën: Tirane, Zall Herr Cerkeze-Morine, Ndertese 2 kateshe, 100 m larg ish Stallave Çekreze.

**Lloji i procedurës se prokurimit:** “Kërkesë për Propozim”.

**Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:** “Rikonstruksion dhe adaptim në ambientet e laboratorit”

**Numri i referencës së procedurës/lotit:** REF-46679-12-23-2019

**Fondi limit:** 2.588.423(dy milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH.

**Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** 20 ditë duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:** 07/01/2020 Ora: 09:00

**Buletini i Njoftimeve Publike:** Nr. 52 DATE 30.12.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara

1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik**“KMK” sh.p.k** NIPT-i L78223801E  
**“CAUSHI/M”sh.p.k** NIPT-i L88419801O  
Vlera: 2.410.275 (dy milion e katërqind e dhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë)lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik **“2 N”shpk** NIPT-i L31615017L  
Vlera: 1.877.989(një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.

Vlera: 2.511.674 (dy milion e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër)lekë pa tvsh.

Vlera: 2.278.815 (dy milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

Vlera: 2.381.317,61 (dy milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë presje gjashtëdhjetë e një) lekë pa tvsh.

### Të skualifikuar, për arsyet si më poshtë:

1..Oferta e paraqitur nga **BOE”K.M.K”sh.p.k &”Caushi/M”sh.p.k** me ofertë **2.410.275 (dy milion e katërqind e dhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë)lekë pa tvsh.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 10 si më poshtë cituar:

13.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera

Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	2 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 20 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 4 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

- a)** *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerese/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jone aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b)** *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c)** *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d)** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e)** *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f)** *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).*
- g)** *(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 06.01.2020 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë*

*vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatoreve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbuloohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër; dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.*

*Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni nje shkresë prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.*

Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “KMK ”sh.p.k & “Caushi”sh.p.k kanë deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

Per te permbushur kriterin kamion me kapacitet mbajtes min 3.5 ton- max 5 ton per secilin kamion( 2 cope).

- Kamion me targa **AA139CJ** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,2 ton.
- Kamion me targa **AA794KK** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,49 ton. certifikata e kontrollit teknik mban daten e perfundimit te afatit te vlefshmerise 02.11.2019.
- Kamion me targa **AA 870EK** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3,2 ton.

Mjeti i mesiperm eshte siguruar nepermjet kontrates se qerese date 04.01.2020 nepermjet qeradhensit R.Hazizaj dhe qeramarresit firma K.M.K

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetin e mësipërm operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, ,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Bashkimi I Operatoreve Ekonomik “KMK ”sh.p.k & “Caushi”sh.p.k kanë deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

Per te permbushur kriterin kamioncinë me kapacitet mbajtes min 1.5 ton- max 2 ton per secilin kamioncinë( 2 cope).

- Kamioncine me targa **AA136XO** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,1 ton.
- Kamioncine me targa **AA179ID** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,2 ton certifikata e kontrollit teknik mban daten e perfundimit te afatit te

vlefshmerise 11.12.2019.

Mjeti i mesiperm eshte siguruar nepermjet kontrates se qerese nr.3744rep, nr.694 kol .

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetin e mësipërm operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, taksë vjetore, foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

- Kamioncine me targa **FR0456D** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,42 ton. Polica e sigurimit per mjetin ne fjale mban daten e perfundimit te afatit 22.11.2019 dhe certifikata e kontrollit teknik mban daten e perfundimit te afatit te vlefshmerise 30.10.2019.

#### **Sa më sipër cituar bashkimi i operatoreve ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:**

- Paraqitjen e 2 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 1,5 ton dhe max 2 ton** pasi nuk ka paraqitur asnjë kamionçinë me kapacitetin e kërkuar nga AK.
- Paraqitjen e 2 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 3,5 ton dhe max 5 ton** pasi nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitetin e kërkuar nga AK.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga „BO”K.M.K&”Caushi”sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, Tel: 00 355 42240978, [info@ukt.al](mailto:info@ukt.al).

**e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në DST.

2.Oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “**L.T.E Konstruksion**”shpk me vlerë **2.278.815 (dy milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi se oferta përmbush të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit.

Më datë 08.01.2020 pranë Autoritetit Kontraktor UKT sh.a është protokolluar shkresa e operatorit ekonomik “L.T.E Konstruksion”shpk me lëndë ”Kërkesë per terheqje nga procedura” prot hyrës 428,datë 08.01.2020 me anë të së cilën parashtron arsyet e tërheqjes nga procedura objekt prokurimi.

Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetet në ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i cili në nenin 94, “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1 parashikon se “**Si rregull, në**

**procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën per tërheqje nga procedura.**” Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik pjesëmarrës është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt prokurimi dhe për rrjedhojë të mos shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik “L.T.E Konstruksion”shpk .

Heqja dorë nga oferta e paraqitur nga operatori ekonomik për procedurën objekt prokurimi sjell për rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Përsa më sipër KVO vendos **të skualifikojë** operatorin ekonomik “L.T.E Konstruksion”shpk.

3. Oferta e paraqitur nga”**2N** ”sh.p.k me ofertë **1.877.989(një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur

pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 10 si më poshtë cituar:

13.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	2 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 20 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 4 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

**h) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e**

*mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerese/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

- i) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- j) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- k) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- l) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- m) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor; UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*
- n) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në datë 06.01.2020 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë pranë Drejtorisë së Prokurimit UKT sha.*

Operatori Ekonomik “2 N ”sh.p.k ka deklaruar deklaruar në shtojcën nr.9 se disponon mjetet e mëposhtme:

Per të permbushur kriterin kamion me kapacitet mbajtës min 3.5 ton- max 5 ton për secilin kamion( 2 cope).

- Kamion me targa **AA948HS** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4,3 ton i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve 3,5 -5 ton.
- Kamion me targa **AA198LP** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 6,8 ton.

Mjeti i mesipërme është siguruar nepermjet kontratës së qerës nr. Rep 1637, nr.kol 112/1 nepermjet qeradhensit B&D Shahini Construction shpk dhe qeramarresit firma 2N.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet e mësipërme operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, ,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.



Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Operatori Ekonomik “2 N”sh.p.k ka deklaruar deklaruar në shtojcën nr.9 se disponon mjetet e mëposhtme:

Per te permbushur kriterin kamion me kapacitet mbajtes min 1.5 ton- max 2 ton per secilin kamion( 2 cope).

- Kamioncine me targa **AA895** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,52 ton.
- Kamioncine me targa **AA967XX** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2 ton.

Mjetet e mesiperme janë siguruar nepermjet kontrates së qerasë nr. 1856 Rep, nr.361/1 nëpermjet qeradhensit Ismet Darsi dhe qeramarresit firma 2N.

**(Për këto mjete Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Certifikatën e transportit për të tret, mbështetur në Udhëzimin Nr. 15 datë 24.07.2007 “Kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuar me udhëzimin nr.5 datë 17.02.2011, në të cilin sanksionohet se: Vetëm kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit” si rrjedhojë dokumentacioni për këtë mjet nuk do të konsiderohet i rregullt.)**

**Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk i përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:**

- Paraqitjen e 2 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 1,5 ton dhe max 2 ton** pasi nuk ka paraqitur asnjë kamionçinë me kapacitetin e kërkuar nga AK.
- Paraqitjen e 2 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 3,5 ton dhe max 5 ton** pasi ka paraqitur nje kamion me kapacitetin e kërkuar nga AK.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ”2 N”sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke

mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i paplotë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në DST.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, Operatori ekonomik “ARB-Trans-2010”shpk me NIPT L02325001T, me administrator Z. Fatmir Firi, me seli në Adresën: Tirane, Zall Herr Cerkeze-Morine, Ndertese 2 kateshe, 100 m larg ish Stallave Çekreze, me vlerë të ofertës: 2.381.317,61 (dy milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë presje gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH, **se është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 08.01.2020

**Ankesa:** Nuk ka patur.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**REDI MOLLA**